



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____/2023
Dt. 28.02.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit 03/L-040, Për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.110/04-29365 të datës 30.12.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2023, pas diskutimeve lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për caktimin e Lokacionit për Vendorsjen e Shtatores së heroit të Kombit Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, e miratoi këtë :

V e n d i m

1. Caktohet Lokacioni për Vendorsjen e Shtatores së Heroit të Kombit Gjergj Kastrioti– Skënderbeu, në parkun e qytetit të Gjakovës në pjesën e parcelës P 70705029-00468-23 Z.K Gjakovë Qytet, e cila është në Pronësi të Komunës së Gjakovës .
2. Në parcelën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të Vendorsset Shtatorja e Heroit të Kombit Gjergj Kastrioti – Skënderbeu .
3. Obligohen organet e Administratës të Komunës së Gjakovës që ti ndjekin procedurat e parapara administrative dhe në harmoni me dispozitat e Legjislacionit në fuqi për zbatimin e këtij Vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

5.Vendimi iu dërgohet:

- z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

Arbëneshja Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës